

20222633935

Në bazë të nenit 158-g pika 7) dhe nenit 158 –II paragrafët (2) dhe (4) të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 188/2013, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018, 198/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” (nr.101/2019, 31/2020), Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, në seancën e mbajtur më 30.11.2022 solli

LISTË TË TARIFAVE PËR NDRYSHIMIN E LISTËS SË TARIFAVE PËR PËRMBAJTJEN DHE VLERËN E TARIFAVE DHE KOMPENSIMEVE QË ARKËTOHEN NË AGJENCINË E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

Neni 1

Në Listën e Tarifave për përmbajtjen dhe vlerën e tarifave dhe kompensimeve që arkëtohen në Agjencinë e Mbikëqyrjes të Sigurimeve dhe afatet e pagesës (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 147/2009, 149/2009, 154/2009, 20/2012, 130 / 2013, 1/2015, 22/2016, 16/2017 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 23/2020 dhe 78/2020), në nenin 4 ndryshohet paragrafi (8) si vijon:

“(8) Kompensimet e përcaktuara në numrat tariforë nga neni 3 i kësaj Liste të Tarifave paguhet në Agjencinë e Mbikëqyrjes të Sigurimeve, në numrin e llogarisë në denarë:

- 210065288480132, banka pranuese: NLB Banka SHA Shkup
- 200002007041251, banka pranuese: Stopanska Banka SHA Shkup
- 270065288480139 banka pranuese: Halk Banka SHA Shkup"

Neni 2

Kjo listë e tarifave hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 01-853/1
30.11.2022
Shkup

Këshilli i Ekspertëve
Kryetar,
Крсте Шајноски, d.v.